



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr.13/2009

Më 21.04.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

Munguan: Ethem Çeku, Slobodan Petroviq dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Ali Hamiti, Theranda Beqiri dhe Ejup Hasolli – ZRRE-ja, Remzije Hajdari - MTI, Haxhi Gashi – USAID, Lumnije Murati – Zyra e Presidentit, Blerina Uka – NDI dhe Ramadan Klisurica - KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14.04.2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të ZRRE-së për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14. 04. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 14.04.2009 u miratua me vërejtjet e deputetit Fatmir Rexhepi, i cili kërkoi të hiqet nga procesverbali diskutimi i tij.

III. Shqyrtimi i Raportit të ZRRE - së për vitin 2008

Kryetarja - Tha se në këtë pikë të rendit të ditës do të shqyrtohet Raporti vjetor për vitin 2008 i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (më tutje në tekst ZRRE) dhe ia dha fjalën z. Ali Hamiti, për ta paraqitur Raportin vjetor.

Ali Hamiti - kryetar i Bordit të ZRRE-së – Shkurtimisht i paraqiti parimet e Raportit të vitit 2008 për ZRRE-në, në të cilin janë përmbledhur veprimtaria kryesore e Zyrës gjatë një viti kalendarik, puna e Bordit Drejtues, puna e shërbimeve profesionale, e shërbimeve teknike, administrative, ku përfshihen të gjitha aktivitetet e sektorit të energjisë, të gazit dhe të ngrohjes qendrore. Po ashtu e paraqiti edhe punën e çdo departamenti, si të Departamentit për Furnizim me Energji, për Mbrojtje të Konsumatorëve, për Çmime dhe të Departamentit për Çmime dhe Tarifa. Theksoi se deri në fund të vitit 2008 Bordi ka qenë i përfaqësuar vetëm me 3 (tre) anëtarë, ndërsa tani është i kompletuar me 5 (pesë) anëtarë. Vitin 2008 e cilësoi sfidues për Bordin e ZRRE-së, edhe pse me 3 (tre) anëtarë arriti t'i përmbushte detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. U ndal në disa prej pikave konkrete të Zyrës, si rishikimi i tarifave për energjinë elektrike, rishikimi i tarifave për ngrohjen qendrore, po ashtu edhe për industrinë e gazit. Ndonëse ende nuk ka ndonjë infrastrukturë, ZRRE-ja, ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha forumet, në të cilat është trajtuar çështja e gazit në rajon. Në Raport, krahas të dhënave të hollësishme të industrisë elektrike është përfshirë KEK-u. Në Kosovë e vetmja industri elektrike është KEK-u, që përfshinte edhe KOSTT-in, tani të ndarë nga KEK-u, por që vepron si njësi e veçantë. KEK-u është paraqitur me të dhëna edhe për gjenerimin, transmisionin, distribuimin, konsumatorët, furnizimin, importin, eksportin dhe për këmbimin e energjisë gjatë vitit 2008 me të gjitha shifrat. Në të është përfshirë edhe raporti financiar për vitin 2008, që është dhënë në bazë të zërave dhe të kategorive të shpenzimeve, të të hyrave. Është përfshirë edhe buxheti me të hyrat dhe me shpenzimet gjatë vitit 2008. Njoftoi se Zyra është e përfaqësuar edhe në projektin e madh “Kosova e Re”. Aty është një përfaqësues me të drejtë vote për përcaktimin e ecurive të realizimit të Projektit. Duke bërë fjalë për industrinë e KEK-ut, theksoi se prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë, si prodhim vendor, nuk mjafton për t'i përmbushur kërkesat, andaj është dashur të importohet një sasi e energjisë. Energjia e importuar nuk ishte e një vëllimi të tillë që t'i përmbushte nevojat e tërësishme të konsumit të Kosovës. Edhe gjatë vitit 2008 ka vazhduar të zbatohet i ashtuquajtur i programi i furnizimit “ABC”. Tha se çështje tjetër që duhet të theksohet, është çmimi i energjisë elektrike për import, që ishte i lartë, kurse shpenzimet e KEK-ut ishin të mëdha. Edhe KOSTT-i, e kreu punën e vet, e rregulloi edhe operimin e sistemit të transmisionit dhe të tregut dhe nuk pati probleme të mëdha në transmision.

Siç dihet edhe transmisioni ka kufizime fizike të bartjes së energjisë elektrike. Në qoftë se në 110 kwh, edhe brenda Kosovës, unaza dhe degët diagonale të saj nuk mjaftojnë më shumë se për një sasi të caktuar të energjisë njëkohshe, maksimumi është 850 mw, që është një fuqi që e lejon sistemin të transmetojë pa problem brenda Kosovës. Për një shpenzim më të madh se 850 mw, në pjesë të ndryshme të sistemit, paraqiten fyte të ngushta, që duhet të menaxhohen. Distribucioni është ballafaquar me shkurtime edhe me ndërprerje të shumta, për shkak të rrjetit të dëmtuar, të vjetruar dhe të pamjaftueshëm të distribucionit për ta çuar energjinë elektrike me cilësi të caktuar deri te shpenzuesit e fundit. Për këtë arsye ka humbje të mëdha teknike deri 17.1%. Sa i përket gazit, theksoi se Projektligji, që ka kaluar në Kuvend, në lexim të parë, ka shumë mangësi dhe kundërthënie. Është shumë vështirë të editohet dhe të bëhet i pranueshëm për mratim. Sidoqoftë Projektligji është, por ai duhet të punohet, sepse sektorit të gazit, në fund të fundit, i nevojite një ligj, në bazë të të cilit duhet të zhvillohet dhe të menaxhohet si një resurs alternativ shumë i rëndësishëm për Kosovën. Sa i përket ngrohjes, z.Hamiti, tha se tash janë 2 (dy) ngrohore në dy qytete - në Prishtinë dhe në Gjakovë - të cilat kanë një kapacitet ngrohës që nuk i përmbush nevojat e asnjërit. Me kapacitetet energjetike që i kanë, dërgojnë deri te shpenzuesi i fundit. Në tremujorin e parë kemi pasur pengesa për shkak të mungesës së karburanteve për ngrohore, ndërsa tremujori i fundit, i stinorit të ngrohjes, ka qenë më i mirë se vjet. Sa u përket marrëdhënieve me vendet e tjera, z. Hamiti, tha se ZRRE-ja ka pasur kontakte dhe bashkëpunim rajonal ose ndërkombëtar me asociacionet e tjera, sidomos në komunitetin e energjisë elektrike, përkatësisht me Traktatin e Athinës, në të cilin Kosova është nënshkruese e tij për themelimin e një tregu të përbashkët në Evropën Juglindore. Gjatë vitit të kaluar, ZRRE-ja ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me një rregullator të fuqishëm të SHBA-ve, atë të Linoit dhe pati takime e seminare ndërmjet të dy rregullatorëve. E paraqiti problemin e hapur me Serbinë për qasje të transmisionit, sepse operatori ynë i transmisionit të energjisë elektrike nuk njihet nga Serbia. Kosova është e lidhur drejtpërdrejt me Serbinë, madje jo vetëm sistemi i Evropës Juglindore, por edhe ai i Evropës e më gjerë është i lidhur me të. Ka probleme të ndërsjella. Shtoi se një ankesë e operatorit të Kosovës është duke u shqyrtuar në kuadër të komunitetit të energjisë dhe pritet që në bazë të kompetencave të parashikuara me ligje dhe rregulla të Traktatit të shqyrtohet ky kontest.

Kryetarja - Pas ekspozesë së z. Hamiti ua dha fjalën deputetëve që të shtrojnë pyetje për sqarimin e disa pikave të Raportit.

Haki Shatri – E përkrahu Raportin dhe e vlerësoi të nivelit të lartë, që i plotëson kushtet për procedim të mëtutjeshëm në seancë. Nuk u ndal te pjesa e buxhetit, sepse është objekt shqyrtimi i Komisionit për Buxhet. I shtroi disa pyetje: Për rrymën që distribuohet, sa është çmimi dhe a ndikon në çmimin e tarifave? Sa ka qenë ZRRE-ja e përfshirë në hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ZRRE-në? Çfarë veprimesh janë ndërmarrë pas shpalljes së Pavarësisë për t'i eliminuar pengesat në rrjetin elektrik me Serbinë?

Berim Ramosaj –Raportin e cilësoi të nivelit të lartë dhe bëri vërejtje të eliminohet pjesa hyrëse e tij, sepse është e panevojshme. Sugjeroi që ZRRE-ja të punojë për një zyrë sa më të pavarur dhe të gjejë forma që sa më shumë të bëjë presion te menaxhmenti i KEK-ut,

në mënyrë që ky të përmirësohet në të ardhmen.

Kaqusha Jashari – Raportin e cilësoi gjithëpërfshirës. Theksoi se ai ka nevojë edhe për analiza më të thella. Nuk u pajtua me çmimin dhe me humbjet komerciale. Tha edhe pse me makineri të vjetër KEK-u ka një prodhimtari të mirë që është për t'u vlerësuar.

Sala Berisha – Shala – Tha se në vitin e fundit është përmirësuar furnizimi me energji elektrike. Pyeti për tarifatat ditore të energjisë elektrike: A ka pasur kërkesë nga konsumatorët dhe KEK-u për ndryshimin e tarifave ditore? Tarifatat e ngrohjes qendrore janë paushall, a do të ndryshohet kjo situatë dhe a do të ketë matje reale? Po ashtu u interesua të dinte se kush nuk i përgjigjet detyrimit: institucionet apo qytetarët? Cili është qëndrimi i ZRRE-së për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ZRRE-në? Po ashtu u interesua a ka kërkesa nga bizneset e tjera, përveç ALFERON-it, që të jenë konsumatorë të privilegjuar?

Zef Morina – Raportin e vlerësoi lart. Kërkoi nga përfaqësuesit e ZRRE-së të shpjegohet ndryshimi i çmimit të energjisë së importit dhe të eksportit, sepse rryma çdoherë blihet më shtrenjtë, ndërsa shitet më lirë. A jeni konsultuar me afaristët që të ketë mirëkuptim në këtë drejtim?

Safete Hadërgjonaj – Meqenëse ky raport do të diskutohet në Komisionin për Buxhet, nuk bëri pyetje sa i përket pjesës buxhetore. U ndal në kreun V: Mbrojtja e konsumatorit dhe kërkoi nga ZRRE-ja të shpjegojë sa është bërë në këtë drejtim për ta mbrojtur konsumatorin. Sipas saj ai është i pambrojtur dhe nuk respektohet pikërisht neni 15.2.

Kryetarja – Tha se Raporti i ZRRE-së është i kompletuar dhe ka pasqyrë reale. Pyeti: A duhet të ketë ZRRE-ja plan paraprak njëvjeçar për nevojat e energjetike? Si po veprohet me licencat ad - hoc dhe çka duhet të bëjë KEK-u në të ardhmen që ta përmirësojë gjendjen e furnizimit me energji elektrike?

Ali Hamiti - kryetar i Bordit të ZRRE-së – Iu përgjigj pyetjeve të deputetëve. Tha se në çmimet e importit dhe të eksportit në treg nuk mund të ndërhyhet, aq më pak në çmimin e energjisë elektrike. Pothuajse çdoherë 1 mgw rrymë e blejmë 112.5 euro, ndërsa e shesim për 54 euro, sepse ne kemi rrymë për të shitur vetëm natën, në atë kohë kur nuk i duhet pothuajse askujt. Sa i përket Ligjit në fuqi për ZRRE-në, është i mirë dhe i harmonizuar me direktivat e Komisionit Evropian. Ndërkaq Projekti i plotësimit dhe i ndryshimit është në kundërshtim me frymën e këtyre direktivave dhe nuk kuptohet se kujt i konvenon që një pjesë e kompetencave të ZRRE-së t'i kalohen një institucioni tjetër. Problemi i KOSTT-it me Serbinë është politik dhe nuk mund ta zgjidhim, por vetëm mund t'i ndjekim procedurat që i kemi nisur në Traktatin e Athinës. Sa i përket çështjes së humbjeve, nuk përkon me fushën e kompetencave të ZRRE-së. Ishte një pilotprojekt me kartela mbushëse, mirëpo për shkak të largimit të prodhuesit, është tërhequr. Sa i përket ngrohjes qendrore, është çështje e sistemit dhe është e pamundur të vendosen orëmatës. Plani për të, në vitin që vjen, bëhet në mënyrë të hollësishme dhe është i realizueshëm. Licencat jepen për dy vjet dhe përsëriten. ZRRE-ja nuk ka ingjijrenca të rekomandojë se ku blihet as ku shitet energjia elektrike. ZRRE-ja i zbaton, por nuk i

krijon politikat, sepse çështja si do të veprohet në privatizim i takon shtetit. Është Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit në ZRRE dhe çdo ditë merren ankesa të qytetarëve. Ata mbrohen vetëm në caktimin e tarifave. ALFERON-i është konsumator i privilegjuar. Ai çdo vit bën kërkesë për ripërtëritjen e kontratës. Në këtë kategori FERRONIKEL-i, TREPÇA dhe SHARR CEM-i janë biznese vendore. ZRRE-ja nuk e rregullon çështjen e konsumatorëve të privilegjuar.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet në parim Raporti i ZRRE-së për vitin 2008.

dhe këtë

REKOMANDIM

- I. Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta procedojë për shqyrtim dhe për miratim Raportin e ZRRE-së për vitin 2008.

IV. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë

Kryetarja – Ia dha fjalën z. Shatri, referues i Projektligjit, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë.

Haki Shatri - Njoftoi se për ekonomizim të kohës, në përgjithësi, është zvogëluar numri i amendamenteve. Janë përmbledhur të gjitha vërejtjet vetëm në një nen, në një amendament. Tani janë gjithsej 18 amendamente. Vuri në pah se në amendamentin 8, sipas versionit të fundit, janë evidencuar disa lëshime të administratës, që kanë të bëjnë me numër të anëtarëve të Zyrës për Ankesa, që duhet të jetë 3 (tre). Përfaqësimi ka mbetur ashtu si ishte dhe janë pajtuar që anëtarët të jenë shërbyes civilë dhe nga biznesi përkatës i naftës.

Me këto korrigjime u pajtuan të pranishmit.

Fatmir Rexhepi - Kishte vërejtje lidhur me formulimin e paragrafit 6 të amendamentit të njëjtë (8). Ky paragraf Komisionit ia kufizonte të drejtën të merrte vendime meritore, gjegjësisht përfundimtare, për çështjen përmbajtjesore. Këto vërejtje u mbështetën edhe nga anëtarët e tjerë.

Haki Shatri - E propozoi amendamentin e ri, të radhitur nën 13, që inspektoratit ia njehtë drejtën, që kur shkelen dispozitat e nenit 18 të paragrafëve: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Projektligjit, të nisë procedurën e pezullimit të licencës.

Të pranishmit u pajtuan me këtë amendament.

Propozoi amendamentin 15, sipas versionit të ri, që me nenin 19.1 të Projektligjit, të kufizohet koha brenda së cilës, për shkak të shkeljes së dispozitave, shkelësit t'i shumëfishohen masat ndëshkimore.

Komisioni nuk u pajtua me këtë amendament.

E propozoi edhe një amendament të ri, me të cilin anëtarëve të Këshillit të Licencimit, sipas nenit 3 të Ligjit në fuqi, t'u vazhdohet mandati ekzistues, që ka mbetur. Në përputhje me këtë ata duhet të kalojnë në cilësi të anëtarëve të Zyrës së Licencimit si shërbyes civilë.

Komisioni njëzëri u pajtua edhe me këtë amendament dhe e autorizoi administratën ta radhisë atë sipas vlerësimit. Komisioni i miratoi të gjitha amendamentet, gjithsej 18 dhe e autorizoi Zyrën Mbështetëse t'i rregullojë në mënyrë tekniko –juridik e gjuhësore dhe për mbledhjen e radhës të vlerësohet saktësia e Raportit të amendamentimit të këtij projektligji.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Në mbledhjen e radhës të verifikohet saktësia e amendamentimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë.
- II. Njësia Mbështetëse e Komisionit t'i spastrojë dhe t'i sistemojë të gjitha propozimet e miratuara.

V. Të ndryshme Çështjet vijuese

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës pikë e rendit të ditës të jenë shqyrtimi i Raportit vjetor të ART-së dhe i Projektligjit për Gazin Natyror.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani